



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 61
Prishtinë, më 24 maj 2012

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 24 DHE 25 MAJ 2012**

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Sabri HAMITI**.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 61 deputetë.

Në fillim të mbledhjes, Kuvendi, me propozim të Kryetarit, mbajti një minutë heshtje në shenjë nderimi për studentët që kishin humbur jetën në aksident trafiku, në Himarë të Shqipërisë.

Në vazhdim, Kryetari sqaroi kuptimin e rekomandimeve, që i kishte miratuar Kuvendi në mbledhjen e kaluar, lidhur me zbardhjen e fatit të personave të zhdukurve në raport me bisedimet me Serbinë.

Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Ministri Fehmi Mujota, në emër të Qeverisë së Kosovës, propozoi që Kuvendi të heqë nga rendi i ditës pikën - shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, me arsyetimin se duhet bërë harmonizimi i neneve në këtë projektligj.

Kryetari kërkoi nga deputetët që të deklarohen, lidhur me propozimin e ministrit, Fehmi Mujota.

Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, të hiqet nga rendi i ditës dhe t'i kthehet Qeverisë në ripunim.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e këmbimit të Notave Diplomatike për statusin e forcave të huaja mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Teatrot,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbeturina,
12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2011,
13. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2011,
14. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2011,
15. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2011,
16. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2011,
17. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2011,
18. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2011,
19. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2011,
20. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Kosovës, lidhur me “Listën për Rentat Minerare”,
21. Shqyrtimi i Propozimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
22. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Xhevahire Izmaku, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Afrim Kasolli, Sasha Milosavljeviq, Valbona Dibra, Alma Lama, Xhevdet Neziraj, Goran Marinkoviq dhe Halit Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Nazane Breca, parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me hetimet e inspektoratit shëndetësor lidhur me keqpërdorimin e mundshëm të detyrës nga drejtori i klinikës interne.

Ministri Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes Nazane Breca.

Deputetja Aurora Bakalli, parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me vendimin për baras-vlerësimin e përvojës profesionale shëndetësore.

Ministri Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes Aurora Bakalli.

Deputetja Time Kadriaj, parashtoi pyetje për ministrin Ibrahim Makolli, në lidhje me numrin e librave të dërguara, çmimin e botimit dhe transportin e tyre në Gjermani, Austri dhe Zvicër, për furnizimin me lektyra shkollore në shkollat shqipe në diasporë.

Ministri Ibrahim Makolli, iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadriaj.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 10 maj 2012

Kuvendi miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 10 maj 2012.

Deputeti **Ramiz Lladrovci** kërkoi që në transkriptin e mbledhjes plenare të datës 10 maj 2012, të zbardhet diskutimi e tij, i plotë lidhur me diskutimin për zbardhjen e fatit të zhdukurve në raport me bisedimet me Serbinë.

Kryetari, duke iu referuar një konstatimi në transkript lidhur me mënyrën e procedimit të votimit, sqaroi se kryesuesi i mbledhjes plenare nuk ka të drejtë të ndikojë te deputetët se si të votojnë lidhur me rekomandimet e paraqitura nga Komisionet parlamentare.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e këmbimit të Notave Diplommatike për statusin e forcave të huaja mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, të paraqes dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e këmbimit të Notave Diplommatike për statusin e forcave të huaja mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ministri **Enver Hoxhaj** tha se ky Projektligj ka për qëllim ratifikim e këmbimit të Notave Diplommatike për statusin e forcave të huaja mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila është në pajtim me Konventën e Vjenës për marrëdhënie diplomatike.

Në vazhdim theksoi se Projektligji siguron kornizën ligjore për personelin e SHBA-së, të cilët nuk janë pjesë e NATO-së, si dhe rregullimin e bashkëpunimit me FSK-në.

Në fund, ministri Hoxhaj i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ratifikimin e këmbimit të Notave Diplommatike për statusin e forcave të huaja mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e këmbimit të Notave Diplomatieke për statusin e forcave të huaja mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hydajet Hyseni - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Vjosa Osmani - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Rexhep Selimi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Jelena Bontiq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari, në vazhdim konstatoi se në bazë të nenit 60.3 të Rregullores së Kuvendit, procedimi i projektligjit për ratifikim e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Më pas, kryetari hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e këmbimit të Notave Diplomatieke për statusin e forcave të huaja mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	98,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Miratohet Ligji nr.04/L-122 për ratifikimin e këmbimit të Notave Diplomatieke për statusin e forcave të huaja mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, të paraqes dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Ministri **Bedri Hamza** tha se qëllimi i këtij Projektligji është plotësimi dhe ndryshimi i ligjit nr.03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Në vazhdim theksoi se ky Projektligj është në përputhje me prioritetet e Qeverisë që kanë të bëjnë me ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale dhe obligimet që dalin në raport me institucionet financiare ndërkombëtare.

Projektligji nuk do të ketë kosto financiare, mirëpo me miratimin e tij, buxheti i Kosovës do të arrijë të përfitojë nga marrëveshja me FMN-në dhe institucionet tjera financiare me karakter ndërkombëtar, theksoi Ministri.

Në fund, ministri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadergjonaj - në emër të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, Hasime Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Naser Osmani - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Muhamet Mustafa - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Haki Demolli dhe Armend Zemaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 86,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën Kontestimore

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, të paraqes dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore.

Ministri i Drejtësisë, **Hajredin Kuçi** tha se ky Projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-006 për procedurën kontestimore, plotësimin e dispozitave që kanë qenë në kolizion me ligjet tjera, si dhe eliminimin e pengesave procedurale me të cilat janë ballafaquar gjykatat dhe palët gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore.

Më pas ai u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi - në emër të Komisionit funksional për Legjislacion, Halit Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Armend Zemaj - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit

Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Amir Ahmeti - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Jasmina Zhivković - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Vjosa Osmani dhe Arsim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	66,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit të paraqes dhe arsyetojë Projektligjin për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve.

Ministri **Bedri Hamza** tha se kjo fushë deri më tani ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2005/14 për taksën rrugore të automjeteve.

Në vazhdim theksoi se ky Projektligj është në përputhje me prioritetet e Qeverisë që kanë të bëjnë qëndrueshmërinë makrofikale, planin zhvillimor ekonomik dhe në harmoni me marrëveshjet që Kosova ka me institucionet ndërkombëtare financiare.

Më tej, ministri, theksoi se Projektligji rregullon taksën rrugore për automjetet e regjistruara në Republikën e Kosovës dhe gjithashtu rregullohet çështja e vendosjes së taksës ekologjike për automjetet e regjistruara në Kosovë dhe për automjetet e huaja.

Në fund, ministri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hasime Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hykmete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jelena Bontiq – në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Arben Gashi, Aurora Bakalli, Lumnije Morina, Rexhep Selimi, Haki Demolli dhe Sali Asllanaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 39,
Kundër----- 23,
Abstenime----- 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, të paraqes dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat.

Ministri **Nenad Rashiq** tha se ky Projektligj ka për qëllim njohjen dhe garantimin e lirive dhe të drejtave për organizmin dhe pjesëmarrjen e të punësuarve në grevë, sipas ligjeve të aplikueshme dhe standardeve ndërkombëtare.

Në vazhdim, ministri Rashiq theksoi se e drejta për grevë është një e drejtë fundamentale e të drejtave të të punësuarve e njohur në të gjitha vendet e botës.

Nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat rrjedh edhe nga Raporti i Progresit për Kosovën i dalë nga Komisioni Evropian, tha ai.

Më pas ai u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e këtij Projektligji, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Kurtan Kajtazi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Thaqi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Liburn Aliu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Time Kadrijaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Suzana Novëbërdaliu - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Boban Todoroviq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Salie Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 68,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Teatrot

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për teatrot.

Raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, e paraqiti deputeti, Idriz Vehapi.

Për këtë pikë diskutuan edhe deputetët: Teuta Haxhiu, Sali Morina, Idriz Vehapi, Sabri Hamiti dhe Myzejene Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21 dhe amendamentin nr. 22.

Kuvendi nuk miratoi këto amendamente: 2, 3, 5 dhe amendamentin nr.13.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	34,
Kundër-----	15,
Abstenime-----	12.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për teatrot.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore.

Për këtë pikë të rendit ditës diskutoi deputeti, Liburn Aliu, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, dhe amendamentin nr. 14.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	42,
Kundër-----	4,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbeturina

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për mbeturina.

Raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e paraqiti deputeti, Nait Hasani.

Pastaj, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 – i plotësuar sipas diskutimit të deputetit Nait Hasani, 15 – i plotësuar sipas diskutimit të deputetit Nait Hasani, 16, 17, 18, 19 – i plotësuar sipas diskutimit të deputetit Nait Hasani, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39 dhe amendamenti nr.40.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	62,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për mbeturina.

12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2011

Deputeti Ahmet Isufi, në emër të Komisionit Funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu Raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fatmir Xhelili - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Vjollca Krasniqi- në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Alma Lama - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Safete Hadergjona - në emër të Komisionit

për Buxhet dhe Financa, si dhe: Rexhep Selimi e Salie Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale , për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2011.

13. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2011

Deputeti, Nait Hasani, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Niazi Idrizi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sali Morina - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Liburn Aliu - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe: Safete Hadergjonaj, Ali Sadriu, Shaip Muja dhe Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56,
Kundër----- 5,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina, për vitin 2011.

14. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2011

Deputeti, Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadergjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Zenun Pajaziti - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Teuta Sahatqija - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të

Grupit Parlamentar të lëvizjes ”Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe: Armend Zemaj e Zenun Pajaziti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 54,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2011.

15. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2011

Deputeti Armend Zemaj, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadergjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Halit Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes ”Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Suzana Novoberdaliu - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 49,
Kundër----- 7,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2011.

16. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2011

Deputetja, Teuta Sahatqija, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ajo në fund përkrahu Raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadergjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së, Teuta Sahatqija - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Alma Lama - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes

”Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Agim Kuleta, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2011.

17. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2011

Deputetja Teuta Sahatqija, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ajo në fund përkrahu Raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadergjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së, Teuta Sahatqija - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Alma Lama - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes ”Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2011.

18. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2011

Deputeti Idriz Vehapi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Xhevahire Izmaku - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Eqrem Kryeziu - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Kasolli - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Milivoje Stojanović - në emër të Grupit Parlamentar SLS, si dhe Arsim Bajrami, Jakup Krasniqi, Armend Zemaj, Adem Grabovci e Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2011.

Në vazhdim, kryetari propozoi që Kuvendi, t'i përfundojë punimet për ditën e sotme për t'i vazhduar nesër, më 25 maj 2012.

Kuvendi miratoi propozimin e kryetarit.

Kryetari e mbylli mbledhjen plenare në orën 18:22 minuta.

E premte, 25 maj 2012

Vazhdim i mbledhjes plenare

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Sabri HAMITI**.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 24 maj 2012. Ai procedoi me pikën numër 19 të rendit të ditës.

19. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2011

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadergjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Zenun Pajaziti - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Teuta Sahatqija - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Ahmet Isufi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Biserka Kostiq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa, Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar "6+", si dhe Ali Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin 2011.

20. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Kosovës, lidhur me "Listën për Rentat Minerare"

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision kemi shqyrtuar Propozimin të Qeverisë së Kosovës, lidhur me "Listën për Rentat Minerare" dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu Propozimin të Qeverisë së Kosovës, lidhur me "Listën për Rentat Minerare".

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Teuta Sahatqija - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa, Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar "6+", si dhe Halit Krasniqi, Teuta Sahatqija e Zenun Pajaziti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim Propozimin e Qeverisë së Kosovës, lidhur me "Listën për Rentat Minerare".

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 40,
Kundër----- 7,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi Propozimin të Qeverisë së Kosovës, lidhur me "Listën për Rentat Minerare".

21. Shqyrtimi i Propozimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, tha se si komision kemi shqyrtuar Propozimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe kemi rekomanduar miratimin në mbledhje plenare.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Propozimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arsim Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Armend Zemaj - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Ahmet Isufi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Suzana Novoberdaliu - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar "6+", diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin Propozimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 57,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, njëzëri, mori këtë

V E N D I M

I. Anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, emërohen:

1. Fejzullah Hasani - Gjykata Supreme e Kosovës,
2. Nebojsa Boriqiq - Gjykata Supreme e Kosovës,
3. Laura Pula - Prokuroria Publike e Kosovës,
4. Osman Ismaili - Fakulteti Juridik,
5. Rexhep Murati - Shoqata e Juristëve të Kosovës,
6. Idain Smaili - Shoqata e Prokurorëve të Kosovës,
7. Ramë Gashi - Oda e Avokatëve të Kosovës,
8. Ymer Hoxha - Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës.

II. Mandati i të emëruarve nga pika **I.** e këtij vendimi zgjat dy (2) vjet.

22. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës

Deputeti **Zenun Pajaziti**, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si Komision kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe Kuvendit ia kemi paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej ai u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur Komisioni funksional.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Teuta Sahatqija - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ndërsa Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	60,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Miratohet Raporti, me rekomandime, i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Kryetari konstatoi të mbyllur punimet e mbledhjes së sotme në orën 11: 27 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale